

Vendim nr. 203 datë 22.07.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Marsida Xhaferllari,	Anëtare
Genti Ibrahim, i,	Anëtar

në datën 22.07.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 10 (D) 2025 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **DRITAN BRAHIMI**

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 5915, datë 23.11.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë; nr. 05 (86-2018-5), datë 15.01.2018 të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2025-194, datë 28.01.2025 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 30, 42, pika 2, 44, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, si dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 310 i Kodit të Procedurës Civile (*KPC*); neni 27 i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjo i relatorin e çështjes Genti Ibrahim i, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në datën 30.05.2012 kërkuesi ka filluar marrëdhëniet e punës në Drejtorinë e Arkivit Qendror (*DAQ*) të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, me detyrën “operator”, e më pas, prej datës 13.05.2013, ka mbajtur detyrën “jurist/inspektor”. Në datën 09.04.2015, në zyrën ku kërkuesi bashkë me pesë kolegë të tjerë ushtronin detyrën, ka pasur një konflikt mes tij dhe juristes D.N. Të dy punonjësit janë shoqëruar në Komisar iatin e Policisë nr. 1, Tiranë. Shtetasja D.N. ka paraqitur kallëzim penal ndaj kërkuesit, me të cilin ishin kolegë zyre, duke pretenduar se ka pasur mosmarrëveshje të karakterit personal. Sipas saj, kërkuesit i ishte krijuar ideja se në zyrë e shanin pas krahëve dhe për këtë arsye disa herë e kishte lënë telefonin e tij në opsionin për përgjim, me qëllim që të regjistronte bisedat. Sipas kallëzueses, në datën 09.04.2015, ajo i ka marrë kërkuesit aparat i n e telefonit për ta bërë problem dhe kur kërkuesi i është afruar për ta marrë ajo nuk ka pranuar t’ia japë. Sipas saj, kërkuesi e ka kapur nga krah u duke ia marrë me forcë aparat i n e telefonit, për pasojë ajo është përplasur tek tavolina. Ky pretendim është mohuar nga kërkuesi, si për sa i përket vënies në përgjim, ashtu edhe konfliktit fizik dhe sipas tij ngjarjet e pretenduara nga kallëzuesja nuk janë provuar të kenë ndodhur.

2. Materiali kallëzues është referuar nga komisar iati në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (*Prokuroria e Tiranës*), e cila, në përfundim të hetimeve, me vendimin e datës 08.05.2015, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal.

3. Ndërkohë, ditën pas ngjarjes, në datën 10.04.2015, kryetarja e degës juridike të DAQ-së i është drejtuar komisionit disiplinor për fillimin e procedimit disiplinor për të dy punonjësit e përfshirë në ngjarjen si më sipër. Me shkresën e DAQ-së së datës 10.04.2015, në zbatim të nenit 144 të Kodit të Punës, kërkuesi është njoftuar për t’u paraqitur pranë komisionit disiplinor në datën 14.04.2015 për takim.

4. Me shkresën nr. 1670, datë 16.04.2015, drejtuar drejtorit të DAQ-së, komisioni disiplinor ka rekomanduar masat disiplinore “Largim nga puna” për kërkuesin dhe “Vërejtje me shkrim” për punonjësen D.N. Në vijim, kërkuesi është njoftuar për takimin në zyrën e drejtorit në

datën 17.04.2015. Nga aktet bashkëlidhur kërkesës rezulton se kërkuesi, për arsye shëndetësore, nuk është paraqitur në takim.

5. Me urdhrin nr. 1735, datë 20.04.2015 të DAQ-së, ndaj kërkuesit është dhënë masa disiplinore “Largim nga puna” për sjellje të parregullt gjatë kohës së punës me eprorët dhe kolegët, si dhe për kryerjen brenda kohës së punës të veprimeve që ulin ose cenojnë figurën e punonjësit të sigurimeve shoqërore.

6. Kërkuesi, duke pretenduar se zgjidhja e kontratës së punës është bërë në kundërshtim me dispozitat e Kodit të Punës, në datën 09.10.2015 i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me padi, me objekt detyrimin e DAQ-së (e paditura) ta dëmshpërblejë me 12 paga mujore për zgjidhjen e menjëhershme e të pajustificuar të kontratës së punës, dy paga mujore për mosrespektimin e afatit të njoftimit dhe dy paga mujore për mosrespektimin e procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës, përkatësisht sipas neneve 153, pika 3, 143, pika 1 dhe 144 të Kodit të Punës. Kërkuesi ka pretenduar se punëdhënësi nuk ka provuar kryerjen e një shkeljeje të rëndë që do të justifikonte masën disiplinore të largimit të menjëhershëm nga puna, edhe pse barra e provës rëndon mbi të, por është mbështetur vetëm në faktin e paraqitjes së kallëzimit nga shtetasja D.N., duke e konsideruar atë si provë të mjaftueshme për të konkluduar se fakti ka ndodhur dhe se sjellja e paditësit ka qenë joetike. Sipas tij, nuk është kryer një hetim i plotë, pavarësisht faktit se Prokuroria e Tiranës ka vendosur mosfillimin e procedimit penal.

7. Në përfundim të gjyqimit, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 5915, datë 23.11.2015, ka vendosur ta pranojë pjesërisht atë, duke detyruar të paditurën, DAQ-në, të dëmshpërblejë paditësin (kërkuesin) me dy muaj pagë për mosrespektim të procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës. Në lidhje me pjesën tjetër të kërtimeve të padisë është vendosur rrëzimi i saj. Ajo gjykatë, ndër të tjera, ka arsyetuar se punëdhënësi ka provuar se zgjidhja e kontratës së punës është bërë për shkak të punëmarrësit (kërkuesit) dhe sjellja e tij, duke shkelur rregullat e etikës, ka krijuar një situatë të rëndë që nuk lejon, sipas parimit të mirëbesimit, vazhdimin e marrëdhënies së punës. Sipas asaj gjykate, marrëdhënia e punës është zgjidhur nga punëdhënësi në mënyrë të menjëhershme për shkaqe të justifikuara, në përputhje me nenin 153 të Kodit të Punës, ndërsa mosrealizimi i takimit me punëmarrësin (kërkuesin), për shkak të mosparaqitjes së justifikuar të tij, është konsideruar si mosrespektim i procedurave sipas nenit 144, pika 1, të Kodit të Punës, duke i njohur të drejtën e shpërblimit me dy paga mujore. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuesi.

8. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 05 (86-2018-5), datë 15.01.2018, ka lënë në fuqi vendimin nr. 5915, datë 23.11.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke arsyetuar se zgjidhja e marrëdhënies së punës ka qenë e justifikuar. Sipas asaj gjykate, punëmarrësi ka kryer sjellje të parregullta ndaj eprorëve dhe kolegëve, si dhe veprime që cenojnë figurën e punonjësit të sigurimeve shoqërore, të cilat përbëjnë faj të rëndë dhe është konstatuar lidhja shkakësore mes shkeljes dhe ndërprerjes së menjëhershme të punës, duke krijuar një situatë që, sipas parimit të mirëbesimit, nuk lejonte vazhdimin e marrëdhënies së punës, në zbatim të neneve 153, pika 2, dhe 154, pika 2, të Kodit të Punës. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs kërkuesi.

9. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-194, datë 28.01.2025, ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi ai nuk përmban asnjë nga shkaqet e parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të cilat do ta bënin të cenueshëm vendimin e gjykatës së apelit.

10. Në datën 23.05.2025 kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (Gjykata), sipas objektit të tij.

II

Pretendimet e kërkuesit

11. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor në drejtim të:

11.1. *Së drejtës për t’u mbrojtur*, pasi gjykata e shkallës së parë i ka mohuar të drejtën e përfaqësimit me avokat, duke vazhduar gjykimin pa praninë e mbrojtësit në seancën e datës 23.11.2015, megjithëse është paraqitur një kërkesë për shtyrjen e saj për arsye shëndetësore.

11.2. *Parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit*, pasi Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë nuk ka qenë e paanshme dhe e ka paragjykuar zgjidhjen e çështjes, për shkak se nuk i ka vendosur kërkuesit në dispozicion provat e palës së paditur, të administruara në dosjen gjyqësore, bashkë me prapësimet në seancën paraprake.

11.3. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, për shkak se në vendimet e gjykatave të faktit mungon analiza në drejtim të arsytimit të masës disiplinore.

11.4. *Së drejtës së aksesit*, për shkak se Gjykata e Lartë, me vendimin për mospranimin e rekursit, nuk ka shqyrtuar dhe as është shprehur për pretendimet për shkeljet e ligjit material dhe procedural nga gjykatat e faktit.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkesës

12. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

13. Në rastin në shqyrtim, kërkuksi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, pasi është palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor të kundërshtuar në ankimin kushtetues individual, ndaj justifikon interesin në çështjen e parashtruar.

14. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, kërkuksi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta.

15. Kërkuksi legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi që ka përmbysur procesin gjyqësor të kundërshtuar, ai i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, mban datën 28.01.2025, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 23.05.2025, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

16. Në drejtim të legjitimitetit *ratione materiae*, Kolegji vëren se kërkuesi ka pretenduar se gjatë procesit gjyqësor të zhvilluar në gjykatat e zakonshme është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor në disa aspekte të saj.

17. Në lidhje me të drejtën për t'u mbrojtur, kërkuesi ka pretenduar se Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë nuk ka pranuar kërkesën e tij për shtyrjen e seancës gjyqësore të datës 23.11.2015, të paraqitur në bazë të nenit 175 të KPC-së, për shkak të mungesës së avokatit për arsye shëndetësore. Sipas kërkuetit, në këtë seancë, të caktuar për paraqitjen e konkluzioneve përfundimtare nga palët, avokati do të paraqiste kërkesë për riçeljen e pjesëshme të hetimit gjyqësor dhe thirrjen në gjykim, në cilësinë e dëshmitarit, të disa punonjësve të zyrës (ish-kolegë të tij) për të dëshmuar në lidhje me konfliktin e pretenduar nga shtetasja D.N.

18. Në lidhje me këtë pretendim, gjykata e apelit ka vlerësuar se vendimi i gjykatës së shkallës së parë nuk mund të bëhej i cënueshëm për këtë shkak, për sa kohë që avokati/përfaqësuesi i paditësit (kërkuetit) nuk kishte depozituar raport mjekësor në sekretarinë e gjykatës përpara zhvillimit të seancës gjyqësore, si dhe në kushtet kur paditësi ka depozituar në dosjen gjyqësore konkluzionet me shkrim rreth çështjes në seancën e datës 23.11.2015 (faqet 46-40 të dosjes gjyqësore) (*shih faqet 15-16 të vendimit të gjykatës së apelit*). Ky pretendim është ngritur nga kërkuesi edhe si shkak në rekurs, ndërkohë që Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i ka konsideruar të pabazuara shkaqet e parashtruara nga ai për cenimin e vendimit të gjykatës së apelit.

19. Kolegji, referuar akteve bashkëlidhur kërkesës, vëren se gjykata e shkallës së parë, pasi ka administruar provat dhe ka shqyrtuar kërkesëpadinë, përfundimisht në seancën e datës 23.11.2015, pasi ka dëgjuar edhe palët (kërkuesi ka kërkuar pranimin e kërkesëpadisë), ka vendosur pranimin e pjesëshëm të saj sipas dispozitivit të vendimit. Pretendimi i kërkuetit në rastin konkret rezulton se ka të bëjë me seancën gjyqësore në shkallë të parë të caktuar për paraqitjen nga palët të konkluzioneve përfundimtare dhe marrjen e vendimit. Sipas nenit 302 të KPC-së, pasi të jenë shqyrtuar të gjitha provat që gjykata ka pranuar të merren, pyeten palët nëse kanë kërkesa të tjera në dobi të gjykimit të çështjes dhe në rast se ato nuk pranohen, gjykata i jep fund hetimit gjyqësor dhe fton palët të parashtrojnë pretendimet përfundimtare të tyre rreth çështjes në gjykim, të cilat, si rregull, i parashtrohen gjykatës me shkrim. Kurse sipas nenit 304 të KPC-së, pasi i është dhënë fund hetimit gjyqësor, nuk mund të merren prova të tjera, përveçse kur janë kushtet e neneve 151 dhe 186 të këtij kodi, rast në cilin vendos gjykata, sipas vlerësimit të rrethanave të çështjes.

20. Kolegji, bazuar në sa më sipër, si dhe në pretendimet e kërkuessit, vëren se ai nuk ka pretenduar se nuk ka qenë i pranishëm në gjykim dhe se nuk është përfaqësuar nga mbrojtësi gjatë hetimit gjyqësor të zhvilluar në gjykatën e shkallës së parë ose që nuk ka pasur mundësi të paraqesë përpara asaj gjykate konkluzionet përfundimtare me shkrim. Pretendimi i kërkuessit për mospranimin e kërkesës për shtyrjen dhe riçeljen e hetimit gjyqësor ka të bëjë me një moment procedural në të cilin nuk mund të merren prova të reja, ndërkohë që ai nuk ka argumentuar se ka qenë në një nga rastet përjashtimore sipas nenit 304 të KPC-së. Nga ana tjetër, kërkuessi nuk ka arritur as të provojë, në këndvështrimin kushtetues, se mospranimi i kërkesës për shtyrjen e seancës gjyqësore për shkak të mungesës së avokatit për arsye shëndetësore, në këtë fazë të gjykimit, ka ndikuar drejtpërdrejt në të drejtat e tij gjatë procesit gjyqësor, duke i bërë të pamundur ushtrimin efektiv të së drejtës së mbrojtjes. Prandaj, thjesht kjo rrethanë nuk është e mjaftueshme për ta konsideruar procesin gjyqësor të zhvilluar në atë gjykatë të parregullt në kuptimin kushtetues. Në këto kushte, ky pretendim i kërkuessit është haptazi i pabazuar.

21. Kërkuessi ka pretenduar edhe cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit në gjykim, pasi gjatë seancës përgatitore në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë ai ka kërkuar që t'i vihen në dispozicion provat e palës së paditur, por kjo është kushtëzuar me paraqitjen nga kërkuessi të vendimit të Prokurorisë së Tiranës për mosfillimin e procedimit penal. Megjithatë, sipas kërkuessit, në seancën e radhës të datës 19.11.2015, vendimi i prokurorit i është paraqitur gjykatës dhe avokati ka kërkuar kohë të njëjhej me provat e palës tjetër, por gjyqtari ka vendosur të kalojë në pretendimet përfundimtare me gjithë kundërshtimin e avokatit dhe duke mos e pasqyruar këtë kundërshtim në procesverbalin gjyqësor.

22. Gjykata ka theksuar se e drejta për proces të rregullt përfshin edhe të drejtën e palëve në proces për të pasur informacion për argumentet e palës kundërshtare, që nënkupton në parim mundësinë që palët në një seancë gjyqësore të kenë njohuri edhe për komentet mbi provat e nxjerra. Në këtë mënyrë gjykatës i dalin një sërë detyrash, mes të cilave rëndësi të veçantë merr krijimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve ose përfaqësuesve të tyre në proces, si dhe mundësia e deklarimit të tyre për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që janë të lidhura ngushtë me çështjen që shqyrtohet në gjykatë (*shih vendimet nr. 38, datë 02.12.2021; nr. 8, datë 23.02.2021; nr. 34, datë 29.05.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Referuar standardeve të mësipërme dhe pretendimeve të kërkuessit, Kolegji vëren se ai u është referuar në mënyrë të përgjithshme provave të palës së paditur, por nuk ka arritur të

argumentojë dhe të provojë se cilat kanë qenë ato prova me të cilat ai nuk ka pasur mundësi të njihet gjatë gjykimit ose për të cilat nuk ka mundur të marrë dijeni dhe se për këtë shkak atij i është pamundësuar ushtrimi i së drejtës për t'i kundërshtuar ato. Për rrjedhojë, ky pretendim i kërkuarit, për sa kohë nuk është argumentuar në këndvështrimin kushtetues, është haptazi i pabazuar.

24. Në lidhje me pretendimet për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor dhe së drejtës së aksesit si element i një gjykimi të drejtë, kërkuari ka pretenduar se gjykatat e faktit nuk u kanë dhënë përgjigje si pretendimeve të tij për cenimin e të drejtës së mbrojtjes si shkelje procedurale, ashtu edhe pretendimit të tij thelbësor se ai ishte larguar nga puna në mënyrë të kundërligjshme nga punëdhënësi. Po sipas tij, vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, që ka vendosur mospranimin e rekursit, është i paarsyetuar, duke legjitimuar shkeljet e kryera në shkallët e tjera të gjykimit.

25. Gjykata ka theksuar se kontrolli kushtetues ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit, kurse problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përfshihen në juridiksionin kushtetues, nëse nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave. Mënyra sesi gjykatat e zakonshme kanë përcaktuar faktet dhe kanë interpretuar ligjin e zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes në shqyrtim para tyre nuk përbën lëndë kushtetuese. Çështjet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit, të cilat hyjnë në juridiksionin e gjykatave të zakonshme, mund të merren në konsideratë në gjykimin kushtetues vetëm nëse cenohen të drejta ose liri kushtetuese themelore. Në këto raste, Gjykata bën një vlerësim të natyrës kushtetuese, që dallon nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimet nr. 42, datë 19.09.2023; nr. 32, datë 03.11.2022; nr. 3, datë 17.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Kolegji, bazuar në sa më sipër, referuar në tërësi argumenteve të kërkuarit në drejtim të këtij pretendimi, vlerëson se ato kanë të bëjnë me çështje të vlerësimit të provave dhe të interpretimit e zbatimit të ligjit nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Në kushtet që kërkuari nuk ka arritur të argumentojë cenimin e të drejtave kushtetuese për shkak të mënyrës sesi kanë vepruar gjykatat në zgjidhjen e çështjes konkrete, pretendimet mbeten me natyrë të pastër ligjore, ndaj nuk hyjnë në juridiksionin kushtetues dhe nuk mund të merren në shqyrtim.

27. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, shkronjat “a” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.